



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:133763

Datë: 18.11.2021

Numri i dokumentit: 02415375

A.nr.1004/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, me gjyqtarin Krenar Berisha, dhe me sekretaren juridike Nazife Sheholli, në konfliktin administrativ të paditësit N.T.P. [“B...” sh.p.k] me seli në Ferizaj kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike: vlerësim tatimor, duke vepruar sipas Aktgjykimit ARJ-UZVP nr.64/2020 i datës 30.11.2020 i Gjykatës Supreme të Kosovës, në seancën publike të mbajtur me datë 10.11.2021, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, e në mungesë të palës së paditur, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET Kërkesëpadia e paditësit N.T.P. [“B...” sh.p.k] me seli në Ferizaj

ANULOHET Vendimi nr.498/2010 datës 24.02.2011 i Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, dhe Lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje

A R S Y E T I M

Me vendimin kontestues e paditura Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm ATK), e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e paditësit, lidhur me Njoftim Rivlerësimet e Kontrollit.

Paditësi N.T.P. [“B...” sh.p.k] me seli në Ferizaj, me padinë e paraqitur në gjykatë, me datë 03.05.2018, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës ATK-së, me të cilën ka kërkuar aprovimin e padisë dhe kërkesëpadisë në tërësi si të bazuar, dhe që të anulohet vendimi i Departamentit të Ankesave të ATK-së nr.498/2010 dt.24.02.2011.

Në ankesën drejtuar BPR-së, paditësi deklaroi se vendimi i atakuar pa arsyetim të qëndrueshëm dhe pa bazë, ankuesit i vërteton obligimet tatimore në bazë të vlerësimeve arbitrare të personelit tatimor. Vendimi i atakuar edhe pse nuk mbështetet në parashtratat e ankesës, ballafaqimit në Departamentin e Ankesave, deklaratave dhe dokumenteve të prezantuara (dëshmime relevante) në vendimin e datës 24.02.2011 e detyron palën e dëmtuar me detyrime tatimore për të cilat i njëjti organ nuk ka dhënë dëshmi dhe argumente të faktuara por më tepër ka shërbyer si tregues të prezantuar nga vetë inspektori edhe pse vet paneli i Departamentit të Ankesave në ballafaqim me palën paditëse ka dalë në mbrojtje të palës ankuese dhe në kundërshtim publik ndaj inspektores [Z.D]. Në vendim fare nuk shihen arsyet dhe baza për mospranim të evidencës kontabël ndërmjet

softverit, respektivisht mbajtja në mënyrë elektronike e të gjitha evidencave. Në vendim fare nuk është marr për bazë kërkesa e tatimpaguesit për të bërë verifikimin e softverit se a është në përputhje me standardet e kontabilitetit në Kosovë. Tatimpaguesi i ka ofruar panelit të Departamentit të ankesave leje në formë reversi laptopin për verifikimin e evidencave kontabël me të vetmin qëllim për të marrë vendim sa më të drejtë. Është e pakuptimtë se Departamenti i Ankesave ka pranuar si të saktë pjesën e ndëshkimeve nga tatimpaguesit [“B...” sh.p.k] kurse në realitet ajo barrë tatimore është e faturuar në emër të biznesit [“F...”]. Edhe këtu ATK nuk ka dhënë fakte bindëse por për t’ia bërë qejfin inspektorit nga Regjioni i Ferizajt nuk ka refuzuar, duke u bazuar në nenin 136 të LPPA-së nr. 02/L-28. Drejtori i kompanisë [“B...” sh.p.k] asnjëherë nuk ka pasur formularë për caktimin e punëdhënësit kryesor për NPT [“F...”] këtë kemi kërkuar të na argumentohet nëse është ashtu apo e kundërta. Këtë rast diskutabil mund ta kishim vërtetuar duke prezantuar argumentin nga MTI, përndryshe ne nuk mund të pajtohemi me këtë vendim të paargumentuar. Në seancën e shqyrtimit kryesor përfaqësuesi i paditësit ka deklaruar se kërkoj që të merren për bazë vërejtjet që ka dhënë Gjykata Supreme, sipas Aktgjykimit ARJ-UZVP, nr. 64/2020 i datës 30.11.2020 dhe kërkoj nga kjo gjykatë që të marr vendim ashtu që të anulohet vendimin e ATK-së. Obligimet tatimore i kam kryer ndaj ATK-së në vitin 2012, prandaj konsideroj se pa të drejtë jam obliguar ti paguaj këto obligime tatimore me çka vërtetohet me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme dhe me vendimin e BPR-së.

E paditura me parashtrësën e datës 28.10.2021 ka kërkuar nga gjykata që të refuzohet kërkesa e paditësit si e pabazuar, dhe të mbetet në fuqi vendimi i ATK-së nr.498/2010 dt.24.02.2011.

Gjykata ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ gjyqësor (rivendosje) konform dispozitave të nenit 41 të LKA-së, për arsye se e paditura me parashtrësën e datës 28.10.2021 ka njoftuar gjykatën se nuk mund të marr pjesë në seancën gjyqësore dhe propozon që të veprohet konform nenit 38.5 i LKA-së.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave në shqyrtimin kryesor publik të datës 10.11.2021 ka administruar provat relevante dhe atë: Aktgjykimi i Gjykatës Supreme ARJ-UZVP. Nr.64/2020, Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, ankesa e paditësit, vendimi i ATK-së nr.498/2010 i datës 24.02.2011, vendimi i BPR-së nr.35/2011 i datës 14.11.2012, Raporti i kontrollit, aktiviteti i inspektorit, obligimet për pagesë 2007/2008 dhe 2009.

Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81G të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, vlerësoj ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në ankesë, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, thënieve në seancë, konstatoj se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe vendosi që ta kthej lëndën në rishqyrtim sipas vërejtjeve dhe rekomandimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Në arsyetimin e vendimit kontestues e paditura thekson se tatimi shtesë ka rezultuar duke u bazuar në paragonat e tatimpaguesit të cilat i ka pasur në evidencat e shitjes, duke i krahasuar, blerjet nga DUD-at doganor dhe kuponët e shitjes ka nxjerr një marzhë mesatare për çdo periudhë të kontrollës, njëkohësisht duke e nxjerr KMSH (në bazë të stoqeve fillestare të blerjeve gjatë periudhave përkatëse duke i marr në konsideratë stoqet në fund të periudhës) e cila është e konfirmuar se është e njëjtë KMSH si e ka deklaruar tatimpaguesi dhe me marzhën mesatare të nxjerrë është konstatuar qarkullimi shtesë.

Në procedurën e konfliktit administrativ gjyqësor (rivendosje), gjykata pasi ka vlerësuar vërejtjet e Gjykatës Supreme të Kosovës, provat e administruara dhe dispozitat ligjore në fuqi, konstaton se e paditura nuk ka dhënë arsytim të mjaftueshëm për aplikimin e kalkulimit të marzhës që ka sjell deri te përlllogaritja e tatimit shtesë, pasi që nuk është vërtetuar me asnjë dëshmi se si llogaritet koeficienti i marzhës mesatare vjetore në rastet kur ekzistojnë sasitë e ndryshme të artikujve të ndryshëm me çmime të ndryshme të blerjes dhe shitjes. Gjykata nuk e konsideron si të drejt aplikimin e metodës për përlllogaritjen e marzhës mesatare vjetore që ka rrjedh nga dokumentacioni i shitjes me pakicë, kur e paditura ka konfirmuar Njoftim rivlerësimet e kontrollit, ku në bazë të dokumentacionit të paditësit, duke analizuar paragonat, librin e shitjes, librin e blerjes, pasqyrat financiare ka rezultuar me qarkullim shtesë.

Nga arsyetimi i vendimit kontestues i të paditurës nr.498/2010 datës 24.02.2011, gjykata nuk ka mund të konstatoj se kemi të bëjmë me ndonjë provë që dëshmon se paditësi ka nëndeklaruar qarkullimin përmes kuponave të shitjes apo me faturë tatimore të shitjes. Nuk janë gjetur nga kontrolli tatimor parregullsi në mosbarazimin e gjendjes materiale.

Me vendimin A.nr.35/2011 dt.14.11.2012 BPR-së ka aprovuar ankesën e paditësit kundër vendimit nr.498/2010 dt.24.02.2011, ka liruar paditësin nga ngarkesa dhe pagesa e tatimit shtesë me rritjen e marzhës, dhe ka lënë në fuqi qarkullimin dhe tatimin shtesë për vitin 2007 dhe 2009.

Gjykata kërkon dhe i rekomandon të paditurës, që në ri procedurë të merr për bazë vërejtjet edhe rekomandimet e Gjykatës Supreme të Kosovës, ashtu që e paditura ti kushtoj kujdes te veçantë konstatimeve lidhur me metodologjin në përlllogaritjen e koeficientit të rritur të marzhës mesatare vjetore që ka rrjedh nga dokumentacioni i shitjes me pakicë.

Nga një gjendje e tillë faktike, gjykata nga provat e administruara dhe ato të siguruara në procedurën e konfliktit administrativ, aprovoj kërkesëpadinë e paditësit, anuloi vendimin nr.498/2010 datës 24.02.2011 të Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, dhe vendosi që lëndën ta kthej në rishqyrtim tek Departamenti i Ankesave i ATK-së.

Në këtë drejtim, Gjykata bazuar në autorizimet nga neni 81.I par.2 pika 2.2 të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222, nenin 43. par.2 të LKA, e detyron organin e paditur që në ri procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në arsytim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal
A.nr.1004/18 datë 10.11.2021

G j y q t a r i,
Krenar Berisha

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 60 ditësh nga marrja e të njëjtit, në gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.